



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" GJILAN
"KADRIZEKA" UNIVERSITY
FAKULTETI I SHKENCAVE APLIKATIVE
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 01 / 253 dt. 24 / 02 / 2022

Në bazë të nenit 65 pika 4 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, Senati i këtij universiteti, sipas propozimit të Fakultetit të Shkencave Aplikative, në mbledhjen e mbajtur më dt. 24.02.2022 nxori këtë:

R R E G U L L O R E
PËR STUDIMET THEMELORE – BAÇELOR

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

1. Fakulteti i Shkencave Aplikative është njësi akademike në kuadër të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan.
2. Fakulteti i Shkencave Aplikative (FSHA) e ka selinë në Gjilan dhe ofron studime themelore 3 vjeçare (6) semestrare-bachelor.

Neni 2.

1. Studimet themelore bachelor, organizohen dhe mbahen sipas plan-programit mësimor të miratuar nga Këshilli i Fakultetit, Senatit të Universitetit dhe të akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA)
2. Plani dhe programi mësimor, mund të ndryshohet apo të plotësohet gjatë procesit të akreditimit dhe riakreditimit. Ndryshimet apo plotësimet e plan-programeve mësimore miratohen me propozim të Këshillit të Fakultetit dhe miratim të Senatit të Universitetit.

Neni 3

Fakulteti organizon studime të rregullta.

Neni 4.

1. Mësimi realizohet përmes ligjëratave, ushtrimeve teorike, ushtrimeve laboratorike, mësimit praktik, seminareve, kolokuiumeve, konsultimeve profesionale, punimeve të pavarura të studentëve si dhe ekskursioneve me karakter mësimor-shkencor.

2. Lënda mësimore mund të ligjërohet me javë gjatë një apo dy semestrave ose mund të mbahet si bllok ligjëratash në një semestër.

Neni 5.

1. Viti akademik fillon me 1 tetor dhe përfundon me 30 shtator të vitit vijues.
2. Semestri dimëror fillon me 1 tetor dhe përfundon me 15 janar të vitit vijues.
3. Semestri veror fillon me 16 shkurt dhe përfundon me 31 maj të vitit vijues.

II. KOHËZGJATJA E STUDIMEVE

Neni 6.

Studimet themelore bachelor në këtë fakultet zgjasin tre (3) vjet, përkatësisht (6) semestra dhe nevojitet që të plotësohen së paku 180 kredi të ECTS-it deri në përfundim të studimeve.

Studenti duhet t'i sigurojë për çdo vit të studimeve nga 60 kredi nga provimet e dhëna në lëndët obligative dhe ato zgjedhore.

Neni 7.

Me përfundimin e suksesshëm të këtyre studimeve, studenti fiton thirrjen akademike Bachelor (BA) për programin, përkatësisht drejtimin mësimor përkatës.

III. PROGRAMET E STUDIMEVE

Neni 8

1. Fakulteti i Shkencave Aplikative fillimisht ofron studime në programin:

- Matematikë Arsimore

2. Programet e studimit përmbajnë:

- Titullin e studimit;
- Llojin e studimit;
- Thirrjen akademike (titullin akademik);
- Kushtet për regjistrim;
- Objektivat dhe rezultatet;
- Hollësitë mbi plan programin;
- Kompetencat;
- Vlera në pikë sipas ECTS (lëndët, punimi i diplomës) etj.

IV. GJUHA E STUDIMEVE

Neni 9.

- Fakulteti i Shkencave Aplikative organizon studimet në gjuhën shqipe dhe në gjuhët tjera zyrtare të Kosovës.
- Me vendim të Senatit dhe propozim të këshillit të fakultetit ligjëratat mund të mbahen edhe në gjuhë të tjera.

V. REGJISTRIMI NË VITIN E PARË TË STUDIMEVE

Neni 10.

Kandidatët e interesuar për pranim dhe regjistrim në këtë fakultet, duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- të kenë të përfunduar shkollën e mesme dhe të kenë kaluar provimin shtetëror të maturës,
- të kenë kryer shkollën e mesme në Republikën e Kosovës (e cila vërtetohet me diplomë),
- të kenë përfunduar me sukses shkollën fillore dhe të mesme më së paku 12 vjet të shkollimit (të vërtetuar me diplomë përkatëse),
- të kenë të nostrifikuar dhe të vërtetuar diplomën e fituar të shkollimit të mesëm jashtë Republikës së Kosovës nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës.

Neni 11.

- 1.Konkurrimi, pranimi dhe regjistrimi i studentëve të rinj, bëhet në pajtim me kushtet e parapara me konkurs të cilin e shpallë dhe e publikon Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan;
- 2.Kandidati fiton të drejtën për pranim dhe regjistrim kur e jep provimin pranues me sukses duke u bazuar në numrin e pikëve të fituara sipas ranglistës deri në numrin e përcaktuar përpranim në programin, përkatësisht drejtimin përkatës mësimor.
- 3.Provimi pranues mbahet me test, nëse në konkurs nuk parashihet ndryshe.
- 4.Kushtet, afatet, organizimi dhe mënyra e mbajtjes së provimit pranues përcaktohen më detajisht në konkursin të cilin e publikon Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan.

Neni 12.

- 1.Kandidati, i cili nuk e ka fituar të drejtën për regjistrim, ka të drejtë të paraqesë ankesë, të kërkojë sqarime dhe të shikojë testin e tij të dorëzuar për vlerësim.
- 2.Ankesa i paraqitet dekanit të fakultetit në afat prej 24 orësh, nga dita e njoftimit, respektivisht nga dita e publikimit të rezultatit të mbajtjes së provimit pranues.
- 3.Dekani është i detyruar që ankesat e parashtruara t'i dorëzojë pa vonesë në Komisionin për zgjidhjen e ankesave të formuar nga Këshilli i Fakultetit.

Neni 13.

1. Kandidatët, të cilët konkurrojnë në konkurs për pranim, janë të detyruar të paraqesin këto dokumente:
 - aplikimi online përmes web faqes së universitetit.
 - diplomën bashkë me dëftesat e shkollës së mesme (në origjinal, të nostrifikuar nëse është fituar jashtë vendit).
 - certifikatën e lindjes,
 - kopjen e letërnjoftimit.
 - pagesën nga banka për provim pranues.
2. Dokumentacioni dorëzohet tek zyrtari për çështje të studentëve brenda afateve të parapara ligjore.

Neni 14.

1. Përpos dokumenteve të cekura më lartë, kandidatët, të cilët e kanë fituar të drejtën për pranim dhe regjistrim, duhet të dorëzojnë edhe këto dokumente tjera plotësuese:
 - Dëftesën e pagesës në emër të regjistrimit të semestrit /shkarkohet nga web faqja e universitetit/fakultetit
 - Formulari i plotësuar për regjistrim i cili merret në fakultet.
2. Dokumentacioni plotësues, dorëzohet te zyrtari/ja për çështje të studentëve brendaafateve të parapara për këtë qëllim.

VI. STATUSI I STUDENTIT DHE KUSHTET E REGJISTRIMIT TË VITIT VIJUES TË STUDIMEVE

Neni 15.

1. Studenti regjistrohet në këtë fakultet me status të rregullt nëse me konkurs për regjistrim nuk parashihet ndryshe.
2. Me rastin e regjistrimit, studentit i lëshohet kartela e identifikimit (ID).

Neni 16.

1. Regjistrimi në vitin e parë të studimeve bëhet në kohën e përcaktuar me konkurs, konform Statutit dhe vendimit të Senatit të UKZ.
2. Regjistrimi në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve, bëhet në kohën prej 1 deri më 15 tetor.
3. Vërtetimi i semestrave bëhet në kohën prej 15 deri më 20 janar (për semestrin dimëror) dhe prej 1 deri më 5 qershor (për semestrin veror).

Neni 17.

1. Studenti i rregullt, është i detyruar që të vijojë ligjëratat, ushtrimet, mësimin praktik si dhe t'i kryejë të gjitha detyrimet tjera që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e mësimin të përditshëm deri në përfundimin e studimeve.

Neni 18.

1. Studentit i cili nuk është i rregullt në ligjërata dhe ushtrime, nuk ka të drejtë ta vërtetojë semestrin përkatës dhe as ta regjistrojë atë vijues.
2. Përjashtimisht, studentit i lejohet të vërtetojë semestrin përkatës vetëm në raste të veçantadhe të arsyeshme.
3. Vendimin për këtë e merr dekani i FSHA.

Neni 19.

1. Studenti ka të drejtë të regjistrojë vitin e dytë të studimeve, nëse i ka fituar 70% të kredive apo provimeve nga numri i përgjithshëm i kredive në lëndët mësimore të vitit të parë të studimeve.
2. Vitin e tretë të studimeve, studenti mund ta regjistrojë nëse ka fituar 40% të kredive apo provimeve nga numri i përgjithshëm i kredive nga lëndët mësimore të vitit të dytë të studimeve.

Neni 20.

1. Studenti nuk mund t'i nënshtrohet provimeve të vitit vijues pa i dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak.
2. Studenti, ka të drejtë të përsërisë regjistrimin e vitit të njëjtë të studimeve sa dyfishi ikohëzgjatjes së studimeve.

Neni 21.

1. Studenti i cili në afatin e shtatorit nuk i fiton kreditë e parapara me nenin 19 të kësaj rregulloreje, për regjistrimin e vitit vijues, e përsërit regjistrimin e vitit akademik.
2. Studenti i cili përsërit regjistrimin e vitit të studimeve, paguan tarifën e shkollimit sikur sestudentët tjerë të rregullt.
3. Studenti mund të kërkojë edhe njëherë, që t'i vazhdohet kohëzgjatja e studimeve të rregulltapër një apo dy vite.
4. Vendimin definitiv për këtë, e merr dekani i FSHA.

Neni 22.

Këshilli i Fakultetit, ka të drejtë të merr vendime të posaçme për mbajtjen e statusit të studentit të rregullt në raste të veçanta për të arriturat e studentit në fushën e arsimit, shkencës, teknologjisë, kulturës dhe sportit.

Neni 23.

Studenti mund të kërkojë pezullim (ndërprerje) të përkohshëm nga statusi i studentit të rregullt në këto raste:

- Sëmundje së rëndë,
- Kujdesit për fëmijë nën moshën tri vjeçare si dhe
- Në rastet tjera të justifikuara.

Neni 24.

Studenti, i cili i ka përfunduar të gjitha provimet e parapara me plan dhe program mësimor përdrejtimin përkatës, ka të drejtë të mbajë statusin e studentit të rregullt edhe dy vjet. Gjatë kësaj kohe, studentit duhet t'i përfundojë me sukses të gjitha provimet dhe të jep provimin e diplomës.

Neni 25.

1. Studenti, i cili ka vërtetuar semestrin e gjashtë (6) për herë të parë, gëzon statusin e absolventit.
2. Statusi i absolventit zgjatë një vit. Pas kalimit të kësaj kohe, studenti i cili nuk i ka përfunduar të gjitha provimet me sukses, humbë statusin e absolventit dhe i shtrohet të gjitha obligimeve tjera që vlejné për studentët tjerë (përsëritja e regjistrimit të vitit akademik pagesa e regjistrimitetj.).
3. Absolventët nuk paguajnë tarifën e shkollimit.
4. Pas kalimit të afatit prej 12 muaj (statusi i absolventit), studenti paguan tarifën e shkollimit.

Neni 26.

Studenti pas jo më tepër se dy vjet ndërprerje, mund të regjistrohet përsëri si student i rregullt dhe mund të vazhdojë në programin e njëjtë të studimit që ka qenë valid në kohën e regjistrimit të parë, edhe nëse në ndërkohë është ndryshuar programi i studimit.

Neni 27.

Studenti e humb statusin e rregullt në këto raste:

- kur me dëshirë të vet i braktisë (ndërprenë) studimet,
- kur t'i ketë përfunduar studimet,
- kur nuk i ka përfunduar studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve.

VII. NDËRRIMI I DREJTIMIT TË STUDIMEVE

Neni 28.

1. Studenti ka të drejtë të kërkojë ndërrimin e programit të studimeve në njësinë e njëjtë apo në njësinë tjetër akademike të Universitetit.
2. Studentit i lejohet ndërrimi i programit, nëse së paku 50% të provimeve janë dhënë mesues në programin e mëparshëm e që pranohen në programin e ri të studimeve.

Neni 29.

1. Ndërrimi i programit të studimit lejohet vetëm në kohën e paraparë sipas Statutit të UKZ.
2. Studentit mund t'i lejohet të regjistrohet në programin e ri të studimeve: në vitin e dytë e tutjetë studimeve në programe e drejtime përkatëse mësimore
3. Pëlqimin nga paragrafi 2 të këtij neni, e jep Komisioni i Studimeve, ndërsa vendimin e merr Këshilli i Fakultetit.
4. Ndërrimi i programit të studimit nuk i lejohet studentit i cili duhet sërish të regjistrohet në vitin e parë të studimeve në programin e ri të studimeve.
5. Kërkesa për ndërrim të programit të studimeve, i paraqitet Komisionit të Studimeve të këtij fakulteti.
6. Krahas kërkesës, studenti paraqet edhe certifikatën e provimeve të dhëna të programit të mëparshëm.
7. Kundër vendimit të Komisionit i Studimeve, mund të paraqitet ankesë Këshillit të Fakultetit.

8. Ankesa paraqitet në afatin prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimit të komisionit.

VIII. KALIMI NGA FAKULTETET TJERA

Neni 30.

1. Studenti i cili është regjistruar në fakultetet tjera, ka të drejtë të bëjë kalimin në programet e studimit të FSHA, nëse i plotëson kushtet sipas nenit 29 të kësaj rregullore në programet (drejtimet) përkatëse.
2. Kalimi lejohet në kohën prej 01 deri më 15 shtator dhe prej 15 janar deri më 31 janar, përkatësisht në kohën e paraparë me Statut.
3. Nëse kandidatit i lejohet kalimi në drejtimin përkatës atëherë ai/ajo është i obliguar që përçdo provim të pranuar si dhe lejimin e kalimit të paguaj taksat e përcaktuara nga Udhëzimi Administrativ i MASHTI, në llogari të fakultetit-universitetit.

IX. ORGANIZIMI I PROVIMEVE

Neni 31.

1. Provimet janë publike.
2. Provimet për studimet themelore mbahen në afatet dhe datat e përcaktuara dhe të publikuaranë tabelën dhe web faqen e fakultetit/universitetit.
3. Afatet e rregullta të provimeve janë:
 - Afatin e Janarit - (fillon prej 20 janar deri më 15 shkurt).
 - Afatin e qershorit - (fillon prej 5 qershorit deri më 30 qershor) dhe
 - Afatin e shtatorit -(fillon prej 1 deri më 30 shtator).
4. Afatet e provimeve mund të ndryshohen me vendime të Senatit të Universitetit.

Neni 32.

1. Provimet e publikuara, janë detyruese si për pyetësin ashtue dhe për studentin.
2. Orari i provimeve përcaktohet në atë mënyrë që studenti mos të ketë më shumë se njëprovim brenda të njëjtës ditë.

Neni 33.

1. Orari i mbajtjes së provimeve, shpallet në fillim të vitit akademik.
2. Dekani përpilon dhe publikon orarin e provimeve, pasi ti ketë marrë më parë datat e mbajtjes së provimeve nga shefat e programeve dhe drejtimeve përkatëse mësimore.
3. Ndryshimi i datës së mbajtjes së provimit, lejohet vetëm në raste të arsyeshme me leje të Dekanit.

Neni 34.

1. Paraqitja e provimeve bëhet:
 - për afatin e janarit - prej 5 deri më 15 janar,
 - për afatin e qershorit - prej 1 deri më 5 qershor,
 - për afatin e shtatorit - prej 20 deri më 30 gusht
2. Paraqitja e provimit me vonesë lejohet me vendim të veçantë të dekanit.

3. Paraqitja e provimeve bëhet me ID kartelë përmes sistemit SMU.
4. Për afate të provimeve mund të merr vendime Senati i Universitetit.

Neni 35.

Mësimdhënësi është i obliguar që pas vendosjes së notave në SMU, në afatin e caktuar pas 48 orësh, jo më shumë se 7 ditë, t'ia dorëzojë zyrtarit të shërbimit raportin e provimeve bashkë me listën e studentëve si dhe kopjetfizike të fletëparaqitjeve të shkarkuara nga sistemi i SMU.

Neni 36.

1. Format e mbajtjes së provimit janë:
 - provimi me shkrim,
 - provimi me gojë,
 - provimi me shkrim dhe me gojë,
 - provimi praktik
2. Provimet e kombinuara me shkrim dhe me gojë, mbahen brenda shtatë ditëve.

Neni 37.

Vlerësimi i provimit shprehet me notë:

- | | |
|---|------|
| - nota 10 dhe 9 – sukses i shkëlqyeshëm | A, B |
| - nota 8 – sukses shumë i mirë | C |
| - nota 7 – sukses i mirë | D |
| - nota 6 – sukses i mjaftueshëm | E |
| - nota 5 – sukses i pamjaftueshëm | F |

Neni 38.

1. Provimet vlerësohen nga një pyetës ose me komision.
2. Studenti ka të drejtë të riprovohet në lëndën të cilën nuk e ka dhënë.
3. Studenti ka të drejtë të hyjë më së shumti tri (3) herë në provimin të cilin nuk e ka dhënë.
4. Studenti ka të drejtë të ankohet.
5. Studentit pasi të ankohet, me një arsyetim të bazuar, mund t'i lejohet nga dekani që të hyjë në provim për të katërtën herë. Provimi pastaj mund të mbahet para komisionit prej tre (3) anëtarësh, të cilët janë të emëruar nga dekani i njësisë akademike.
6. Në rast se sërish regjistrohet viti i njëjtë, nuk merret parasysh numri i mëparshëm i provimeve të dështuara të studentit.

Neni 39.

1. Studenti ka të drejtë të parashtojë ankesë me shkrim dekanit të njësisë akademike kundër notës së marrë. Ankesa duhet të parashtrohet brenda dy (2) ditëve të punës pasi të jenë shpallur rezultatet.
2. Ankesa mund të bëhet për këto arsye:
 - 2.1. për provimin me shkrim - parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim;
 - 2.2. për provimin me gojë - parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë;
 - 2.3. për provimin e kombinuar me shkrim dhe me gojë;
 - 2.4. parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim, para hyrjes në provimin me gojë;
 - 2.5. parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë që nënkupton se është pranuar nota nga provimi me shkrim.

3. Pas pranimit me kohë të ankesës, dekani i njësisë akademike e vlerëson pretendimet nga ankesa dhe nëse e vlerëson të arsyeshme formon komisionin e provimit brenda dy (2) ditëve të punës, pasi të jetë pranuar ankesa dhe emëron tre (3) profesorë, por pa pyetësin kundër notës së të cilit është ankuar studenti.

Neni 40.

1. Studenti nuk ka të drejtë të paraqesë ankesë kundër vlerësimit të komisionit.

Neni 41.

1. Provimi i dhënë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje anulohet.
2. Vendimin mbi anulimin e provimit e merr dekani.
3. Kundër këtij vendimi, studenti ka të drejtë ankese.
4. Ankesa i paraqitet Këshillit të Fakultetit brenda 48 orësh nga dita e njoftimit.

Neni 42.

Studenti ka të drejtë të kërkojë shtyrjen e mbajtjes së provimit vetëm në rastet e arsyeshme dhe tëjustifikuara. Vendimin për këtë e merr Dekani.

X. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTËVE

Neni 43.

Studentët e pranuar kanë këto të drejta:

- të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat, ushtrimet teorike, ushtrimet laboratorike, seminarët, mësimin praktik, punën në terren, diskutime shkencore-mësimore, konsultime profesionale, ekskursione me karakter mësimor-shkencor si dhe në forma të tjera të mësimit që organizohen me plan e program mësimor.
- të përdorin pajisjet e fakultetit sipas rregullave përkatëse për mësim dhe ushtrime mësimore.
- ta shfrytëzojnë bibliotekën e universitetit në pajtim me rregullat përkatëse mbi punën e bibliotekës.
- të marrin pjesë në zgjedhjet e studentëve për përfaqësimin e tyre në organet e fakultetit,
- të marrin pjesë në mbledhjet e organeve dhe të komisioneve ku janë caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e tilla me angazhim dhe përgjegjësi.
- të kërkojnë të njihen me rregullat e përcaktuara mbi studimet themelore në këtë fakultet.

Neni 44

1. Studenti, i cili nuk i përmbahet detyrimeve ligjore, statutare si dhe rregullave dhe obligimeve të parapara me këtë rregullore apo me ndonjë vendim të veçantë të dekanit të fakultetit gjatë tërë kohës së studimeve, bënë shkelje të obligimeve të studimeve dhe për këtë përgjigjet në aspektin disiplinor dhe ligjor.
2. Këshilli i Fakultetit i përjashton nga Universiteti përgjithmonë ose përkohësisht studentët që i shkelin rëndë rregullat. Studentët e akuzuar për shkelje kanë të drejtë të dëgjohen nga Komisioni disiplinor, i cili e këshillon Këshillin e Fakultetit. Studentët e përjashtuar kanë të drejtë t'i ankohen Komisionit të ankesave në nivel të njësisë akademike si shkallë e dytë.

Neni 45 (neni 149 i Statutit)

1. Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë prej organeve të Universitetit, të njësisë akademike dhe njësisë organizative që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.

2. Ankesat e tilla i dorëzohen Komisionit të studimeve të njësisë akademike brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.
3. Komisioni i studimeve është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e marrë Këshillit të njësisë akademike, brenda tridhjetë (30) ditëve të punës pas pranimi të ankesës.
4. Ankesa rreth vendimit në shkallë të dytë vendoset nga Senati.
5. Studentët kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin e Senatit në gjykatën kompetente

XI. ORGANIZIMI I STUDENTËVE

Neni 46.

Interesat e studentëve në kuadër të Fakultetit të Shkencave Aplikative realizohen drejtpërsëdrejti në Këshillin e Studentëve dhe përmes përfaqësimit të tyre në Këshillin e Fakultetit

Neni 47. (neni 155 i Statutit)

1. Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore, të cilave mund t'i përkasin të gjithë studentët.
2. Këshilli i studentëve është organ i përfaqësimit të studentëve në Njësinë akademike.
3. Numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit të studentëve është një për qind (1%) i numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt të regjistruar në njësinë akademike, me më së paku pesë (5) dhe më së shumti njëzet e një (21) anëtarë.
4. Anëtarët do të propozohen nga organizata studentore, në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të fituara gjatë zgjedhjeve të studentëve në njësinë akademike, sipas listave prioritare të kandidatëve të publikuara nga organizata studentore, në fillim të fushatës zgjedhore.
5. Anëtarët e secilit këshill të studentëve zgjedhin një kryetar dhe një nënkryetar.
6. Secili këshill i studentëve propozon listën me nga një kandidat për anëtarin student të Senatit për t'u zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve.
7. Mandati i anëtarëve të Këshillit të studentëve të njësisë akademike zgjat dy (2) vjet, pa të drejtë të rizgjedhjes.
8. Kryetari i këshillit të studentëve është anëtar ex officio nga numri i përgjithshëm i anëtarëve studentë të Këshillit të fakultetit. Këshilli i studentëve i secilës njësi akademike zgjedh nga një anëtar student të Këshillit të njësisë akademike.
9. Studentët kanë të drejtë të formojnë asociacione profesionale, shoqata apo klube për çfarëdo qëllimi, të lejuar me Ligjin mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.

PËRFUNDIMI I STUDIMEVE DHE MBROJTJA E PROVIMIT PËRFUNDIMTAR –(mbrojtja e diplomës)

Neni 48.

Studimet themelore 3/tri/ vjeçare-Bachelor në këtë fakultet, përfundojnë pas dhënies së provimit përfundimtar (mbrojtjes së diplomës).

Neni 49.

1. Punimi i diplomës për baçelor punohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushat e caktuara shkencore.
2. Procedurat për aplikim, elaborim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës për baçelor përcaktohen nga Këshilli i Fakultetit.

Neni 50.

Afatet për mbrojtjen e provimit përfundimtar (diplomës) janë:

- afati i janarit,
- afati i qershorit,
- afati i shtatorit,

Neni 51.

1. Mbrojtja e provimit përfundimtar (diplomës), është publike.
2. Mbrojtja e provimit përfundimtar bëhet para komisionit prej tre anëtarësh.
3. Komisionin e cakton dekani në bashkëpunim me shefat e programeve studimore.

Neni 52.

Në provimin përfundimtar (diplomës), studenti duhet të tregojë dituri dhe aftësi teorike që ka arritur gjatë kohës së studimeve, në përvetësimin e temës së dhënë, se temën e ka punuar me metodën që i përgjigjet punimit, se e njeh literaturën dhe din ta përdor atë në mënyrë profesionale dhe të pavarur.

Neni 53.

- Provimi përfundimtar paraqet punën e pavarur dhe profesionale të një problemi ose detyre të caktuar teorike, metodologjike ose profesionale.
- Provimi përfundimtar elaborohet dhe mbrohet individualisht.
- Në raste të veçanta, me vendim të posaçëm të Këshillit të Fakultetit, mund të lejohet elaborimi i mbrojtjes së provimit përfundimtar bashkë nga dy studentë.

Neni 54.

1. Paraqitja për mbrojtjen e provimit përfundimtar bëhet në administratën e fakultetit tekzyrtari apo te personi i autorizuar për këtë çështje.
2. Formularët për paraqitje merren në shërbimin e studentëve.
3. Formulari plotësohet me të gjitha të dhënat për studentin që paraqitet për mbrojtjen e provimit përfundimtar.
4. Krahas kërkesës për paraqitje të provimit përfundimtar, studenti paraqet edhe:
 - ID kartelën
 - Fletëparaqitjen për provim përfundimtar (merret tek referenti për çështje të studentëve)
 - Punimin e diplomës (në katër kopje)

Neni 55.

1. Mbrojtja e provimit përfundimtar (diplomës) mbahet me procesverbal.
2. Procesverbalin e nënshkruajnë anëtarët e komisionit dhe dekani.

Neni 56.

Studenti, i cili me sukses e mbron provimin përfundimtar, fiton thirrjen BAÇELOR për programin përkatës mësimor.

Neni 57.

1. Studenti, i cili e kryen me sukses provimin përfundimtar, i lëshohet certifikatë në emër të diplomës mbi përfundimin e studimeve baçelor të drejtimit gjegjës apo drejtimit gjegjës mësimor dhe diploma origjinale.
2. Formën e certifikatës së diplomës dhe të diplomës origjinale, e përcakton me vendim të veçantë Universiteti sipas Udhëzimit Administrativ nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit së Republikës së Kosovës.

Neni 58.

Diploma i dorëzohet studentit në mënyrë solemne.

Neni 59.

Administrata e fakultetit mbanë evidencën e studentëve të diplomuar.

XII. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 60.

Kjo rregullore hynë në fuqi kur e miraton Senati i Universitetit “Kadri Zeka” me propozim të Këshillit të Fakultetit të Shkencave Aplikative.

Neni 61.

Për të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Statutit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan, Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, si dhe aktet e tjera normative.

Neni 62.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyrën në të cilën është miratuar kjo rregullore.

Gjiilan, 24.02.2022



REKTORI
[Signature]
Prof. Dr. Bajram Kosumi